

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM
KESCO SH.A.
Nr. 5 Dt. 08.03.2019
HQ 1

Arsim Janova
ud. Kryesues i Bordit të ZRrE

Alper Erbas
Drejtor i Furnizimit,
KESCO

08 Mars 2019

Lënda: Komentet e FShU-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Vitin Relevant Tarifor 2019

I nderuar z. Janova,

Ky dokument përmbledh komentet e Furnizuesit me Shërbim Universal (FShU) mbi Raportin Konsultativ (RK) të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Vitin Relevant Tarifor 2019, të publikuar më 22 shkurt 2019.

FShU vlerëson mundësinë e dhënë për t'i ofruar komentet e tij ndaj çështjeve të rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ (RK) të ZRrE-së dhe kërkon nga ZRrE-ja që të shqyrtojë me seriozitet qëndrimin e tij mbi çështjet e ngritura në këtë raport përpara çdo vendimi përfundimtar mbi MAR-in e vitit 2019.

FShU është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRrE-në për t'i diskutuar çështjet e ngritura në RK dhe kundër-argumentet e ofruara në këtë raport.

Me respekt,



Alper Erbas
Drejtor i Furnizimit

Komentet e FSHU-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Vitin Relevant Tarifor 2019

I. Hyrje

Ky raport paraqet komentet e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së (RK) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Vitin Relevant Tarifor 2019, të publikuar më 22 shkurt 2019.

KESCO i licencuar si Furnizues me Shërbim Universal, vlerëson mundësinë për të dhënë vlerësimin e vet në çështjet e rëndësishme të ngritura nga ZRRE në Raportin Konsultativ dhe kërkon nga ZRRE që të shqyrtojë me seriozitet të lartë qëndrimin e tij mbi çështjet e ngritura në këtë raport përpara çdo vendimi përfundimtar mbi MAR-in për vitin relevant tarifor 2019.

KESCO është i gatshëm për t'u takuar me ZRRE-në në çfarëdo kohe për të diskutuar çështjet e ngritura në raportin konsultativ. Versionet elektronike të të gjitha tabelave do të sigurohen për përdorimin e ZRRE-së, kështu që ZRRE-ja mund t'i shfrytëzojë ato në punën e saj.

II. Shitjet dhe Blerjet e Energjisë Elektrike

FSHU ka vërejtur se ZRRE ka përdorur shitje të ndryshme nga ato të përdorura nga FSHU në aplikimin e vet, dhe sasi të ndryshme të blerjes nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë për vitin 2019. Një pikë tjetër shqetësuese mbetet çmimi i parashikuar i importit.

Bazuar Raportin konsultativ të ZRRE-së çmimi për blerjet nga KEK-u është rritur vetëm për normën e inflacionit, megjithatë çmimi i importit është parashikuar 60 €/MWh. Ndërkohë, çmimi mesatar i realizuar në vitin 2018 është 68€/MWh. FSHU është i vetëdijshëm se viti 2018 e ka gjetur KEK-un me disa vështirësi, të cilat kanë ndikuar që KEK të mos jetë në gjendje të operoj dhe prandaj nevoja për import është rritur, megjithatë, duhet theksuar se edhe në vitin 2017 KEK-u prodhoi më pak se parashikimet e gjenerimit. Prandaj, gjatë llogaritjes së çmimit të pritur, ZRRE-ja duhet të marrë në konsideratë edhe pasigurinë e prodhimit të KEK-ut, si dhe faktin se jo të gjithë gjeneratorët e BRE-ve fillojnë të operojnë sipas afateve të paracaktuar në bilancin e energjisë.

Analizat për nevojat e importit orë për orë, bazuar në çmimet e importit në treg që ishin dispozicion më 4 Mars tregojnë se çmimet e pritshme, duke përfshirë edhe ngarkesën për shërbimet ndërkufitare dhe ngarkesën e shërbimit, janë rreth 70-72 €/MWh. Në këtë këndvështrim, ne kërkojmë nga rregullatori që të marrë në konsideratë çmimin aktual të realizuar në vitin 2018 gjatë parashikimit të blerjeve nga importi për vitin 2019.

Kostot me shumicë të pritura për vitin 2019 janë si më poshtë:

Përshkrimi	GWh	Propozimi i ZREE-se € '000	Rishikimi nga KEDS € '000
Blerjet nga KEK-u	3,263	96,266	96,266
Blerjet nga BRE-të e kyçura në nivelin e transmisionit	296	10,126	10,126
Blerjet nga BRE-të e kyçuar në nivelin e shpërndarjes	141.9	5,367	5,367
Importi	41.3	2,477	2,803
Margjina me pakicë	3%	3,427	3,437
Total kostot e shitjes me shumice për FSHU	3,742	117,665	118,000

III. Kostot e Personelit

Pavarësisht nga kërkesat tona të vazhdueshme që ZRRE-ja duhet të pasqyrojë kostot reale të përfshira në OPEX, ZRRE-ja vazhdon të zbatoj kostot e aprovuara gjatë vitit 2018, me një rritje të vogël që reflekton ndryshimet në sektorin e energjisë dhe kërkesat qeveritare, megjithatë ende dallimi midis punonjësve që punojnë në sektori publik (KEK, KOSTT) dhe ato që punojnë në furnizuesin e shërbimit universal (KESCO) janë të larta.

Vazhdimi i rritjes së numrit të konsumatorëve, rritja e shërbimeve dhe ndryshimet e përgjithshme në organizimin e stafit po reflektojnë me rritjen e ngarkesës së punës. Ngarkesa e rritjes së punës rezulton më tej në kosto më të larta operative, e cila nuk është proporcionale as me numrin e punonjësve, as me kostot. Një dallim i tillë vërehet edhe në draft pasqyrat financiare të dorëzuar në ZRRE, që tregojnë një rritje prej 10% të kostove operative të realizuara nga viti 2017 deri në vitin 2018. Për më tepër, rritja e vazhdueshme e numrit të konsumatorëve dhe kërkesat për shërbime më cilësore duhet të reflektohen në kosto shtese të personelit.

Nga ana tjetër, pagat më të larta në sektorin publik me ngarkesë pune shumë më të ulët e ekspozojnë FSHU-ne ndaj kërcënimit të vazhdueshëm për humbjen punonjësve profesional, duke ndikuar gjithashtu në rrjedhën dhe cilësinë e punës.

Kështu, në këtë raport, FSHU konsideron një rritje prej 3% në totalin e OPEX, e cila rritje reflekton nevojat reale të FSHU-se dhe kërkon nga Rregullatori që të shqyrtojë seriozisht analizën dhe të sigurojë trajtim të drejtë dhe të barabartë për entitetet e tjera që veprojnë në të njëjtin sektor.

IV. Kostot e bartshme

FSHU ka vërejtur se ZRRE ka llogaritur më shumë kostot e bartshme për FSHU-në, si për kostot e transmetimit ashtu edhe për kostot të shpërndarjes marrë parasysh se FSHU ka shitje me te vogla, prandaj shitjet më të ulëta duhet të merren parasysh gjate kalkulimeve përfundimtarë. Një korrigjim i tillë aplikohet saktësisht në këtë dokument.

V. Të ardhurat aktuale të rregulluara dhe llogaritja KREV

Gjatë llogaritjes së të hyrave të rregulluara aktuale për vitin 2018, ZRRE ka konsideruar të gjitha të hyrat e raportuara nga FSHU dhe nuk ka aplikuar zvogëlimin për pjesën që FSHU ia ka paguar operatorit të sistemit të shpërndarjes për pjesën që i takon, gjithsej 1.2 milion euro. Për më tepër, ZRRE gjithashtu ka përfshirë edhe të hyrat nga jobalance dhe kompensimet, të cilat tashmë janë përfshirë në llogaritjen e kostove me shumicë, sipas formulës së përcaktuar në Rregullën e Çmimeve të FSHU-se, Shtojca 1 'Llogaritja e të Ardhurave të Rregulluara', neni 2.2 'Kostot e Lejuara të Energjisë me Shumicë'.

Për më tepër, duhet të sqarohet se të hyrat në pasqyrat financiare lidhur me jobalancet dhe kompensimin nga operatori i tregut nuk i tregojnë bilancet neto, prandaj, sa herë që merren parasysh të hyrat duhet të llogariten edhe shpenzimet, një qasje të cilën e ka përdorur FSHU gjatë llogaritjes së kostove aktuale të saj me shumicë për vitin 2018.

VI. Borxhi i keq

Borxhi i keq është një vlerësim dhe vlerë hyrëse e periudhës rregullative. Në vitin e fundit të periudhës së parë rregullative (2017) borxhi i keq u vendos në 4%. Për këtë periudhë rregullative (2018-2022), ZRRE-ja nuk ka përcaktuar nivelin e lejuar të borxhit të keq dhe as ka iniciuar asnjë dokument konsultimi, megjithatë gjate përcaktimit të shpenzimeve të lejuara për FSHU-ne për vitin 2018 ka përdorur të njëjtin kompensim për borxhet e këqija, ashtu siç ishte aplikuar në vitin 2017 (4%) dhe e njëjta është propozuar për vitin 2019.

FSHU nuk pajtohet me këtë qasje, pasi ZRRE nuk po shqyrton hapjen e tregut dhe ndikimin e saj tek Furnizuesi me Shërbimit Universal. Siç është argumentuar disa herë për shkak të zvogëlimit të numrit të konsumatorëve industrialë dhe komercialë - të cilët janë paguesit e rregullt, FSHU do të mbetet kryesisht me paguesit e parregullt, të cilët kanë tendencë të vonojnë dhe / ose refuzojnë pagesat e tyre për faturat e marra, e meqenëse bazuar në ligjin e ri nuk lejohet të shkyçen konsumatorët që ankohen derisa të ketë një vendim nga gjykata dhe duke marrë parasysh punën burokratike dhe të ngadaltë të gjykatave në Kosovë, operimet do të bëhen të pamundura për t'u trajtuar brenda vitit përkatës tarifor.

Duhet të theksohet gjithashtu se për shkak të natyrës së bizneseve që vepron në Kosovë, respektivisht se të njëjtat kompani por që veprojnë në zona të ndryshme mund të kyçen në nivele të ndryshme të tensionit, në presim që shumë konsumatorë të kyçur në nivelin 10 kV të dalin gjithashtu në tregun e hapur, duke ndikuar kështu edhe një herë në arkëtimin e FSHU-se.

FSHU ka llogaritur efektin e hapjes së tregut dhe prandaj kërkon që norma për borxhin e keq të jete 5%, e cila do të ofrojë siguri për punën e përditshme të furnizuesit me shërbim universal. Çdo aplikim më i ulët se 5% do të ekspozojë drejtpërdrejt FSHU-ne uljen e kapitalit punues, prandaj në kërkojmë nga Rregullatori që të konsiderojë rritjen e norames për borxhet e këqija nga 4% -5%.

VII. Propozimi përfundimtar për MAR-in e vitit 2019

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, propozimi përfundimtar i MAR-it të FSHU-se për vitin 2019 për t'u shqyrtuar nga ZRRE është 256.33 milion €, detajet e të cilave janë paraqitur më poshtë:

USS MAR Propozimi për 2019	mil €
It	7.49%
Kostot e lejuara me pakicë	6.35
OPM _{Ct}	6.24
DEPC _t	0.11
Kostot kalimtare (PST_{Ct})	148.46
KOSTT tarifit	29.72
OSSH tarifit	107.89
BRE Fondi	10.84
Kostot e kapitalit punues (WCL_{Ct})	1.70
Kostot e energjisë me shumicë (WHPC)	118.00
Tarifa e licencës	0.01
Faktori i përshtatjeve të ardhurave (ADJ)	(31.01)
BDTA	5.0%
PES MAR	256.33

MAR-i i kërkuar për vitin 2019 reflekton kostot e pritshme për vitin 2019, duke marrë në konsideratë edhe konsumatorët e parregulluar të kyçur në nivelin 35 kV, të cilët janë pagues të rregullt, dhe të cilët kanë ofruar stabilitet financiar. Duke marrë parasysh edhe shitjet e pritshme të vitit 2019, MAR-i i kërkuar është i arsyeshëm dhe si e tillë duhet të konsiderohet nga ZRRE gjatë procesit të vendimmarrjes përfundimtare.